



With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



KATEDRA JEAN MONNET

E E A A B A C

EU ENLARGEMENT AND ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

SHKOLLA VERORE

Legjislacioni dhe institucionet e BE-së për profesionistët e së ardhmes

11 KORRIK – 15 KORRIK 2023

PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR ME ATË TË BASHKIMIT EUROPIAN

Prof. Asoc. Dr. Ph.D. Rezarta Tahiraj

Departamenti i së Drejtës – UNIEL

- Referuar Planit Kombëtar të Integrimit European të Shqipërisë 2016-2020 rezulton se Shqipëria ka bërë një progres të konsiderueshëm në drejtim të përafrimit të legjislacionit të saj fiskal dhe doganor me *acquis communautaire*.
- Le të ndalemi fillimisht në analizimin e arritjeve të përafrimit të legjislaconit fiskal me *acquis communautaire* të cilat janë rezultat i zbatimit të nenit 98 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) që përcakton vendosjen e bashkëpunimit në fushën e tatimeve, duke përfshirë masat që synojnë reformimin e mëtejshëm të sistemit fiskal dhe ristrukturimin e administratës tatimore, me qëllim që të sigurohet efikasitet në mbledhjen e tatimeve dhe luftën kundër evazionit fiskal. Për më tepër, ky bashkëpunim duhet të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis communautaire* në fushën e tatimeve dhe të luftës kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve.
- Në këtë drejtim, Shqipëria dhe BE njohin rëndësinë e përmirësimit të transparencës dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet vendeve anëtare të BE dhe Shqipërisë, në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i masave që parandalojnë mospagimin e tatimeve ose evazionin tatimor.

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

- **Gjithashtu, neni 98 i MSA evidenton domosdoshmërinë e konsultimeve midis Shqipërisë dhe BE me qëllim që të eliminohet konkurrenca e dëmshme e tatimeve midis Shteteve Anëtare të BE dhe Shqipërisë për të siguruar një nivel të barabartë përsa i përket tatimit të biznesit.**
- **Arritjet të cilat evidentohen në fushën fiskale në legjislacionin e brendshëm janë si në vijim: - Ligji “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtua në Republikën e Shqipërisë”, nr. 92/2014, datë 24.07.2014, hyrë në fuqi më 1 janar 2015, harmonizon legjislacionin e Shqipërisë me Direktivën 2006/112/KE.**
- **Në zbatim të këtij ligji u miratua dhe Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 30.01 2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” si dhe një sërë aktesh të tjera nënligjore të cilat trajtohen në mënyrë të detajuar në ciklin e dytë të leksioneve; - Modifikimi i Ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” për ta përafëruar me *aquis communautaire* për sa i përket nivelit dhe strukturës së akcizës së cigareve dhe birrës; - Nënshkrimi i Marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar në datë 19 mars 2014 mbi konsolidimin fiskal të administratës tatimore dhe forcimit të menaxhimit të financave publike si dhe mbi shlyerjen e borxheve, duke përfshirë këtu edhe borxhet për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH);**

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

- **Ulja e barrës tatimore për biznesin dhe individët, duke rritur bazën e tatueshme, hartimin e politikave tatimore që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri dhe nxisin formalizimin e ekonomisë; - Zëvendësimi i sistemit aktual informatik, më 1 janar 2015, nëpërmjet projektit “E-Taxation” me një sistem të ri më modern, më të avancuar dhe më praktik në përdorim, duke njësuar operacionet e administratës tatimore me praktikën më të mira të BE; - Intensifikimi i bashkëpunimit administrativ dhe asistencës së ndërsjellë si edhe efikasiteti i sistemit të brendshëm antikorrupsion dhe hetimit tatimor; - Vënia në zbatim e modulit të analizës së riskut që mundësoi ndërtimin e profileve më të mira të riskut për sektorin industrial apo për çdo tatimpagues që mund të përdorë një metodë specifike për të shmangur tatimet.**
- **Sa më sipër, po rendisim modifikimet e sjella në legjislacionin fiskal shqiptar: - Ligji nr. 83/2014, datë 17.7.2014 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar); - Ligji Nr. 84/2014 ,datë 17.7.2014 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”; Ligji Nr. 85/2014 ,datë 17.7.2014 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); - Ligji nr. 86/2014, datë 17.7.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare” (të ndryshuar);**

- **Ligji nr. 87/2014, datë 17.7.2014 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar); - Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në R.SH”; - Ligji nr. 142/2014, datë 23.10.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”; - Ligji nr. 90/2015, date 23.07.2015 “Për një ndryshim në Ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”;**
- **Ligji nr. 91/2015, datë 23.07.2015 “Për një shtesë dhe ndryshim në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshur); - Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 349, datë 29.04.2015 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 781, datë 14.11.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike, të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive të autorizuara për ofrimin e pajisjeve fiskale” (të ndryshuar).**

- **Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 434, datë 20.5.2015 “Për përcaktimin e normativave për firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale”;** - **Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”;** - **Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”;** - **Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 6/1, datë 17.3.2015 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”;** - **Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 6/2, datë 19.3.2015 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar);** - **Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 17, datë 12.06.2015 “Për përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbimeve që përdoren në realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure nga shoqëritë e kërkimit të hidrokarbureve, të cilat përjashtohen nga pagesa e TVSH-së, si dhe procedurat e përjashtimit”;**

- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 6/4, datë 4.9.2015 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar); - Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 23, datë 7.9.2015 “Për një shtesë në Udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”; - Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 14, datë 13.05.2015 “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 15, datë 18.5.2015 “Për përcaktimin e procedurave për dhënien e informacionit nga çdo person në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën tatimore”; - Udhëzim i Përbashkët i Ministrit të Financave, Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrit të Brendshëm nr. 3492, datë 30.04.2015 “Për koordinimin ndërinstytucional të procedurave standarde të kontrollit fiskal sasior dhe cilësor të naftës së papërpunuar dhe nënprodukteve të saj në Republikën e Shqipërisë”;

- **Qëllimi kryesor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është të ndihmojë tatimpaguesit të paguajnë detyrimet e tyre tatimore në përputhje me ligjet e zbatueshme tatimore dhe të sigurojë që të ardhurat nga taksat të shkojnë në llogaritë e buxhetit të shtetit, duke i ofruar tatimpaguesve një sistem efektiv pagesash. Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian, i krijuar me Urdhërin e Kryeministrit nr.107, datë 28.02.2014, “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian”, për legjislacionin fiskal kryesohet nga Ministria e Financave dhe përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve**
- **Përsa i përket arritjeve në fushën e legjislacionit doganor evidentohet se përafrimi si dhe harmonizimi i legjislacionit të brendëshëm me *acquis communautaire* në fushën doganore është rezultat i zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) dhe specifikisht të neneve 13, 14, 15, 34, 43, 86 dhe 97. Nenet 13, 14, 15, 34, 43 dhe 86 të MSA parashikojnë në veçanti forcimin e bashkëpunimit me vendet e Ballkanit Perëndimor që kanë nënshkruar MSA.**

- **Ndërsa, neni 41 i MSA dhe Protokoli 4 i kësaj marrëveshje përcaktojnë rregullat e origjinës për implementimin e dispozitave të MSA. Neni 97 i MSA që i referohet doganave parashikon detyrimin e Shqipërisë për të përafuar legjislacionin doganor të brendshëm me *acquis communautaire*, bashkëpunimin mes palëve, duke pasur parasysh *acquis communautaire* në fushën e doganave dhe bashkëpunimin për asistencën e ndërsjellë administrative në çështjet doganore.**
- **Arritjet të cilat evidentohen në fushën doganore në legjislacionin e brendshëm mbështeten në këto burime normative: - Kodi Doganor i BE dhe dispozitat zbatuese të tij; - Tarifa Doganore; - Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave; - Aktet në lidhje me Akcizën; - Konventat dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare në fushën doganore. Vlen të evidentohet se këto norma ligjore kanë për qëllim të garantojnë mbrojtjen e interesave financiare dhe ekonomike të Republikës së Shqipërisë, mbrojtjen e vendit nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, lehtësimin e tregtisë, krijimin e një klime të favorshme konkurrence për biznesin, ndalimin e kontrabandës, korrupsionit, zbatimin e njëkohshëm të tarifave doganore, të statistikave të tregtisë së jashtme dhe të politikave të tjera që lidhen me mallrat dhe lëvizjen e tyre, bashkëpunimin ndërmjet administratave doganore të vendeve të ndryshme, etj.**

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

- **Progresi i arritur nga administrata doganore shqiptare në drejtim të përafrimit të legjislacionit doganor me *acquis communautaire* konstatohet në aprovimin e ligjeve të përshkruara si në vijim:**
 - **Ligji nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” miratuar më 31.07.2014. Ky ligj përafron pjesësisht Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit nr. 952/2013 “Kodi Doganor i Bashkimit Evropian” dhe përafron pjesërisht disa akte të tjera të BE. Kodi i Ri Doganor ka hyrë pjesërisht në fuqi dhe aplikohet njëkohësisht me Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar). Pjesa që nuk ka hyrë në fuqi e Kodit të ri Doganor do të jetë e aplikueshme duke filluar nga data 1 qershor 2017, datë në të cilën do të shfuqizohen dispozitat e mbetura të Kodit Doganor të mëparshëm; - Administrata doganore shqiptare ka përditësuar nomenklaturën e mallrave në linjë me versionin 2015 të Nomenklaturës së Kombinuar të BE.**

- **Tarifat preferenciale të vitit 2015 janë përfshirë në sistemin “Asycuda World”; - Aprovimi i një sërë aktesh lidhur me shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, ndalimin e importit të mbetjeve, politikave të brendshme dhe të sigurisë në “Sistemin e Teknologjisë së Informacionit të Doganave”; - Shkëmbimi elektronik i të dhënave me Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e Zi është operacional. Ka një bashkëpunim të mirë me vendet e tjera në kuadër të marrëveshjeve për asistencë të ndërsjellë në çështjet doganore (bazuar në Protokollin 6 të MSA), me qendrën SELEC dhe zyrat e OLAF, Mari-Info dhe SUD;**

- Intensifikimi i bashkëpunimit në fushën e inteligjencës me Ateshe doganor të akredituar në ambasada të ndryshme në Shqipëri apo edhe jashtë saj, por që mbulojnë Shqipërinë, etj. Shqipëria dhe Kosova zbatojnë një marrëveshje të përbashkët për lehtësimin e tranzitit. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbështetet në strategjinë doganore të biznesit dhe miraton çdo vit planin e veprimit në zbatim të saj, në strategjinë e teknologjisë së informacionit dhe dokumentin e politikës së sigurisë si dhe në strategjinë e brendshme për të drejtat e pronësisë intelektuale.
- Ky proces i përafrimit të legjislacionit doganor shqiptar me *acquis communautaire* është rezultat i veprimtarisë së Grupit Ndërinstitucional për Integrim Evropian i cili drejtohet nga Ministria e Financave.

Bibliografi, materiale, dokumenta zyrtare dhe linke për konsultim të mëtejshëm mbi leksionin e sotëm (Reader)

- Bibliografi

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2016 – 2020., Janar 2016, <https://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/PKIE-2016-2020.pdf>

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2017 – 2020., Janar 2017, <http://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/PKIE-2017-2020.pdf>

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2018 – 2020., Janar 2018, <http://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/PKIE-2018-2020.pdf>

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2019 – 2021., Janar 2019, https://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOMB%C3%8BTAR-P%C3%8BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN_Final.pdf.



Kontakt:

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Faleminderit për vëmendjen!

Pyetje?

Assoc. Prof. Dr. Ph.D. Rezarta Tahiraj

Professor of EU Tax LAW - Department of Law
Faculty of Economy
University of Elbasan

rezarta.tahiraj@uniel.edu.al



Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES